

Donika BAKIU

## GJUHA E TË RINJVE NË RRJETET SOCIALE

UDC 316.7:004.773.6/.7

**Abstrakti:** Ky studim, i cili ka për objekt studimi gjuhën shqipe në rrjetet sociale kryesisht gjuhën tek të rinjtë, synon të jep një pamje të përgjithshme, sa më tërësore të shqipes së shkruar në rrjetet sociale. Gabimet drejtshkrimore të shumta që bëjnë në biseda, komente etj. Në këtë punim do të ketë shembuj nga rrjetet sociale ku bëjnë gabime drejtshkrimore të rinjtë. Studimi ynë nuk është për herë të parë që bëhet. Ne kishim disa modele të trajtimeve, por shpresojmë se ky punim do të ketë vlerë sepse jemi munduar të nxjerrim në pah shumë gjëra. Vihet re se fjalët shkruhen përgjithësisht pa zanore. Prirja për të shkurtuar fjalët vihet re sidomos tek fjalët me shumë rrokje (fjalët e gjata) apo edhe shprehjeve gjuhësore. Mund të themi se është krijuar një "kod i përzier" në komunikim çka e bën atë të vështirësohet. Do të përmendim: shkurtimet, zëvendësimi i shkrimit me shenja të tjera grafike, kombinime të këtyre lloj shenjash me njëra tjetrën, përdorimi i shenjave të pikësimit dhe lloji i tyre etj.

**Fjalët kyçe:** Gabime drejtshkrimore, rrjetet sociale, facebook

**Abstract:** This study, which is aimed at studying Albanian language on social networks mainly in the language of young people, aims to give a general overview of the Albanian language written on social networks. Numerous spelling mistakes in conversations, comments, and so on. In this paper there will be examples from social networks where young people spell out spelling mistakes. Our study is not for the first time done, we had some models of treatments, we are hoping that this work will be worth it because we tried to highlight many things. It is noted that the words are generally voiceless. The abbreviation for words is especially noted in words with a lot of syllables (long words), or even linguistic expressions. We can say that a "mixed code" is created in communication, which makes it difficult. We will mention: cuts, replacement of script with other graphic signs, combinations of these types of signs with each other, use of punctuation marks and their type, etc.

**Keywords:** spelling mistakes, social networks, facebook

### Hyrje

"Gjuha shqipe është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar. "

Holger Pedersen

Interneti dhe rrjetet sociale e kanë ndryshuar mënyrën tonë të jetës. Meqenëse këto platforma komunikimi janë të vonshme, ne nuk jemi mësuar në shkollë apo në familje se si duhet të sillemi në llogaritë tona. Edukata apo forma e komunikimit po zhvillohet çdo ditë e më shumë, duke e fituar një lloj mënyre të posaçme se si duhet vepruar në rrjete sociale. Ne në këtë punim, kryesisht, do të merremi me gjuhën e të rinjve në rrjete sociale. Rrjetet sociale tani janë të shumta si: Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter, Blogger, thisnext, flickr, eventful, folkd.com, squidoo, hi5 etj. Rrjetet sociale kanë një depërtim shumë personal dhe publik tek jetët tona dhe jemi shumë të varuar nga këto lloj rrjetesh. Rrjetet sociale i ftojnë njerëzit të bëjnë gjithnjë dhe më publike jetët e tyre duke

shpërndarë fotografi ose duke treguar ku ndodhen. Komunikimi në këto rrjete nuk bëhet duke respektuar shenjat e pikësimit apo të shkruarën e shqipes drejtë, por kemi më shumë përdorim të gjuhës angleze. Vihet re se, përgjithësisht, fjalët shkruhen pa zanore. Prirja për t'i shkurtuar fjalët vihet re, sidomos, tek ato me shumë rrokje (fjalët e gjata) apo edhe shprehjeve gjuhësore. Mund të themi se është krijuar një “kod i përzier” në komunikim çka e bën atë të vështirësohet. Mund të përmendim: shkurtime, zëvendësimi i shkrimit me shenja të tjera grafike, kombinime të këtyre llojeve shenjash me njëra tjetrën, përdorimi i shenjave të pikësimit dhe lloji i tyre etj.

### **Shkurtime që përdoren në rrjetet sociale**

Kemi shumë lloj shkurtimeve me të cilët merremi vesh me miqtë nëpër rrjetet sociale. Disa janë si më poshtë: Prsh (përsëritje), Flm (Faleminderit), Klm (Kalofsh mirë), Klb (Kalofsh bukur), Sps (s'ka përse), Tkshxh (Të kam shumë xhan), T plq (Të pëlqen), Sh bkr (Shumë bukur), Fls (Flasim), Dtl (ditëlindje), Mhb (muhabet), Nsr (Nesër), Nrm (Normal), Vër8 (Vërtetë), Mbf-të mbet në fyt ncnncn – është një lloj mohimi që shprehet pakënaqësi.

Më poshtë do të japim disa shembuj me këto shkurtesa të shënuara më lartë:

“Prsh si jeni? Mir flm!”, “Sa bkr dukesh!”, “Mos i bon mhb atij!”, “Festo sot është dtl jote!”, “Shkr me prof po se ka kthy ende!”, “Ncnncn nuk e kthen ai duhet ti shkrujsh ma shpesh!”.

### **Akronimet**

Gz=shkurt. Gëzohem; H=shkurt Ora; IKM shkurt. Ia kalofsh mirë; KLB=shkurt. Kalofsh bukur, PM=shkurt. Për të mirë, Psh=Përsëritje, TDF=kuptimi original të dua fort, të dashuroj fuqishëm. Më poshtë japim edhe disa shembuj: FLM, FLMSH, SPS, SKGJ, KLM, KLB, GZ, VPP, PRSH, NQS, MGJTH, DMD, DIÇ, MAJTH, MM, MSG, NIS, PS, GJTHS, IKM, TD, TDSH, TKXH, TPF, TDI, MSN etj. (Ibrahimi, 2014)

### **Shkurtime dhe simbole të ndryshme**

Shkurtime luajnë një rol të madh në krijimin e zhargoneve, sidomos te nxënësit dhe studentët. Në anglisht kemi la për laborator, gym për gjimnastikë, maths për matematikë. Në frëngjisht: pneu për pneumatique, velo per velocipede, le metro për “chemin de fer metropolitain”, perme për permission (“leje” në gjuhën ushtarake) etj. Shumë prej këtyre kanë hyrë nga zhargoni në gjuhën letrare p.sh: kilo (në tërë Evropën), piano për pianoforte (ose fortepiano), auto (frëngjisht e gjermanisht) etj. Në Skandinavi kemi edhe bil për automobile, anglisht cab për cabriolet, bus për autobus, foto për fotografi. (Ibrahimi, 2014)

Këto shkurtime përdoren edhe në gjuhën shqipe: faks-fakulteti, profi-profesor, bus-autobus, koka-kokaina, kokaina - edra, kokos, mirupafshim nga anglishtja bye. (Ibrahimi, 2014).

Rënie në fund të fjalës (afereza): kusho për kushëri, tung për tungjatjeta, si dhe shumë shembuj tjerë: auto, bal, barca, basket, cel, ciga, foto, gabi, gym, juve, kilo, kusho, lab, maths, mob, natën, paçim, piano, psiko, tel. (Ibrahimi, 2014)

### **Shenjat e pikësimit**

Ndoshta për shkak të shpejtësisë, shumë rrallë për të mos thënë aspak, në këtë lloj komunikimi nuk përdoren shenjat e pikësimit. Nga ana tjetër këto shenja përdoren më tepër si shprehëse të ndjenjave në komunikim. (BRAME, 2014)

Me poshtë keni shembuj: “Suksese në provim!!!!!!!!!!!!!!!”, “Dashuri pafund!!!!!!!!!!!!!!!”; “Të trashëgoheni!!!!”; “Urime martesë!!!!!!!!!!!!!!!”; “Cfar ka ndodh!!!!!!!!!!!!!!!”; “Mos fol shumë se të ...”, “...Xhi tha!!!!!!!!!!!!!!!”, “A halis e kie???”; “Cfar tha?”, “Xhi thaush mi???”; “Ngushllime!!”, “Shumë keq më erdhi!!!”, “Gëzuar ditëlindjen!!!!!!!!!!!!!!!”.

Përdoret shumë pikëçuditja dhe pikëpyetja, por edhe trepikëshi, madje edhe më shumë se tre pikë. Shenja e apostrofit (') nuk përdoret, qoftë edhe në rastet më klasike të përdorimit, siç është ai i pjesës mohuese (s) para foljeve. Kjo nga mosnjohja e rregullit përkatës në gjuhë: Psh: “Smundet” për “S’mundet”, “Ska gjë” për “s’ka gjë”, “Ska përse” për “s’ka përse”.

Teprime vihen re dhe në zgjatjen e zanoreve në pozicione të ndryshme, për të theksuar një gjendje emocionale të caktuar të pjesëmarrësve në komunikim nëpërmjet këtij veprimi, psh: Ooo lockaaaaaa, Dashuriiiiii, Tkom jeeeeetTkom zeeemër, Ahahahhaa jaaaa doolaaaaa, O zeeemraaa jeeemee paaaskaaa ardh, Per çdo çështje jam mar me çdoo njeeee me 100 veeta, Valla diqka në lidhje me ekonomii ja harova emrin hahahaha, Skam ideeeee, Shpirtusheeee tkoom, Auuu moo luuj, Eee kur te thaaash uneeee, Zemmmraaaa jemmm tduuuu shummm etj.

### **Drejtshkrimi**

Lidhur me aspektet drejtshkrimore të gjuhës, ajo që të bie në sy është mungesa e shkronjës (ë) dhe (ç), një mangësi shumë e madhe që të bie në sy. Disa shembuj: Esht e mire, Miresi kudo.

Shkronja Ç në të shumtën e rastave përdoret vetëm si C, si psh: Cfar ka ndodh? Cfar tha?

Më e keqja është kur shkronja Ç zëvendësohet me Q ose Xh! P.sh.: Qdo herë, Qfar ke, Qfar po ndodh, Loqka jeme, Xhdo dit, Xhdo her, Faleminderit që je pran meje edhe që ma bën xhdo dit e xhdo sekond të jetes te lumtur! Je xhdo gjë që kam!

### **Ndikimi nga gjuhët e huaja**

Gjuhët e huaja kanë ndikim shumë të madh në rrjetet sociale. Përdorimi i shprehjeve dhe fjalëve nga gjuhë te huaja, të plota ose me shkurtime është një element tjetër që vihet re në këtë lloj komunikimi mes të rinjve. (BRAME, 2014)

Bien në sy fjalët në gjuhën angleze që përdoren shumë nga të rinjtë, më poshtë kemi disa shembuj: Two Stars; Thnx my honey; ohh he is my idol too; Pretty; Amazing; With my girls, with my mom, with my family, like father like son; Sooo cute, Beautiful girl, keep calm, Keep CALM It’s My 23<sup>rd</sup> Birthday, this is my beautiful girl, Okay, Thanks, Thank you, OK.

Një pjesë e mirë e fjalëve nga gjuha angleze, për shkak të përdorimit të shumtë janë bërë të njohura mjaft mirë nga përdoruesit e rrjeteve sociale, edhe pse mund të mos jenë përdorues të mirë të gjuhës angleze si psh: THANKS –Faleminderit të cilën e shkruajnë edhe si THNX, ose HONEY që d.t.th mjaltë përdoret shpesh duke të dhënë kompliment, AMAZING që d.t.th – MAHNITËS si dhe shumë fjalë tjera.

### **Përfundimi**

Bota e shenjave jogjuhësore dhe gjuha njerëzore me shenjat e saj tingullore dhe shkrimore në botën e sotme moderne dhe duke bashkëvepruar e krijuar lidhje të drejtpërdrejta e të tërthorta me të, po i shndërrojnë të gjitha komunikimet në shtojcë të vetë njeriut.

Për sa i takon faktorit gjini, nuk është vënë re diferencim mes vajzave dhe djemve në komunikimin me shkurtime e shkurtesa, por me ikona shohim se vajzat i përdorin më shumë se djemtë. Gjatë studimit vërejtëm se përdoret një numër i madh fjalësh në gjuhën angleze edhe pse me shkurtime:

THANK-THNX. Shenjat e pikësimit mund të themi se nuk përdorën aspak si duhet ose nuk i vendosim ku duhet apo i vendosim shumë si psh: “Dashuri pafund!!!!”.

Mund të themi se është krijuar një “**E FOLME E TË RINJVE**” ku ato merrën vesh me njëri - tjetrin. Ortografia është qëndrim / sjellje, por sot ka pak njerëz të qëndrueshëm / të sjellshëm. Ortografia për shkrimet është si photoshop-i për fotot. Nëse përdoret si duhet, bën që çdo gjë të duket e bukur.

**Bibliografi:**

BRAME, O. (2014). Gjuha e të rinjve në rrjetet sociale si një aspekt sociolinguistik i komunikimit. *STUDIME SOCIOLOGJISKE II Përmbledhje e kumtesave nga Konferenca II Shkencore Ndërkombëtare "Gjendja dhe prespektiva e sociolinguistikës sot", mbajtur më 1 nëntor 2013 në Tetovë, UEJL*, (p. 50). Tetovë.

Ibrahimi, M. (2014). Modele krijuese të zhargoneve në gjuhën shqipe-Creation of slangs in albanian language. *STUDIME SOCIOLOGJISKE II, Përmbledhje e kumtesave nga Konferenca II Shkencore Ndërkombëtare "Gjendja dhe prespektiva e sociolinguistikës sot", mbajtur më 1 nëntor 2013 në Tetovë, UEJL*, (p. 39). Tetovë.

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/06/Doktoratura-Darina-Minga-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Gjuhesise.pdf>